



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 10 Mars 2021

Nr: 129

VENDIM

**PËR KTHIMIN PËR PLOTËSIM TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE
PËR DEPUTET TË DEPOZITUAR NGA PARTIA “BINDJA DEMOKRATIKE” PËR
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neni 67, neni 72 dhe neni 73, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe udhëzimit nr.1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,

V Ë R E J:

Partia “Bindja Demokratike” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

Në bazë të nenit 67 dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, Partia “Bindja Demokratike” ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listave shumëmemërore.

Në bazë të nenit 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listat shumëmemërore të kandidatëve për deputet të Partisë “Bindja Demokratike” dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur. Në përfundim të procesit të verifikimit paraprak u konstatuan parregullsi dhe mospërmbushje të dokumentacionit si më poshtë:

1. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Tiranë**, nuk është në përputhje me pikën 4 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, duke mos plotësuar numrin e kërkuar me 1 kandidat;
2. Kërkesa për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Tiranë**, nuk është në përputhje me pikën 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, përkatësisht



në kandidatët me numër rendor 26. z. Erkin Qeraxhi, 27. z. Abdyl Merkjja, 28. z. Gentjan Muça të listës shumemërore;

3. Kërkesa për regjistrimin e listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Tiranë** ka parregullsi në numrin rendor 19 të saj;
4. Në zonën zgjedhore **Qarku Tiranë** nuk korrespondon emri në listën shumemërore me dokumentacionin e kandidimit për kandidatin me numër rendor 36, zj. Edlira Gjoka;
5. Në zonën zgjedhore **Qarku Tiranë**, deklarata e kandidatit (model 05) rezulton të ketë të pa përzgjedhur seksionin e deklaramit për kandidatin me numër rendor 4, z. Genti Lasku dhe rezulton të ketë të pa përcaktuar qarkun e kandidimit për kandidatin më numër rendor 30, zj. Loria Pashaj;
6. Në zonën zgjedhore **Qarku Tiranë**, në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 22, zj. Mardena Kelmendi rezulton se në rubrikën “A”, vendbanimin është pa plotësuar, mungon nr. ID si dhe formulari i vetëdeklarimit nuk është sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
7. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet në zonën zgjedhore **Qarku Tiranë** me numër rendor 28, z. Gentian Muça, pika 8 rezulton e paplotësuar por janë specifikuar të dhëna.
8. Në zonën zgjedhore **Qarku Berat**, rezulton i pa përcaktuar qarku i kandidimit për kandidatin më numër rendor 8, zj. Xhuvana Çela në deklaratën e kandidatit (model 05);
9. Në zonën zgjedhore **Qarku Berat**, ka parregullsi në dokumentacionin e kandidimit për deputet i kandidatit me numër rendor 9, zj. Xhuliana Dervishi në listën shumemërore
10. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet në zonën zgjedhore **Qarku Berat** me numër rendor 6, z. Veli Gjishiti, rubrika II rezulton të pa plotësuar.
11. Në zonën zgjedhore **Qarku Durrës**, rezulton i pa përcaktuar qarku i kandidimit për kandidatët më numër rendor 1, zj. Briana Bino, 12. z. Albi Ceno, 13. zj. Silvana Mataj në deklaratën e kandidatit (model 05);
12. Kandidati me numër rendor 14, zj. Elda Pano për zonën zgjedhore **Qarku Durrës** nuk ka të plotësuar në mënyrë të rregullt “Model 05” dhe “ Model 07”, pasi shpreh vullnetin për të kandiduar si deputete e subjektit zgjedhor “Bindja Demokratike” në **Qarkun e Korçës**;
13. Mungon dokumentacioni i kandidimit i kandidatit me numër rendor 15, z. Fatjon Kana për zonën zgjedhore **Qarku Durrës**;
14. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Durrës** me numër rendor 12, z. Albi Ceno, në rubrikën A nuk ka plotësuar vendbanimin si dhe pika 8 rezulton e pa plotësuar;



15. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Durrës** me numër rendor 13, zj. Silvana Mataj, pika 6,7,8 rezultojnë të pa plotësuar ndërsa faqja 6 rezulton të jetë e pa firmosur.
16. Rezulton i pa përcaktuar qarku i kandidimit për kandidatin më numër rendor 3, z. Shahin Aliaj, për zonën zgjedhore **Qarku Gjirokastrë** në deklaratën e kandidatit (model 05);
17. Në zonën zgjedhore **Qarku Lezhë**, rezulton i pa përcaktuar qarku i kandidimit për kandidatët më numër rendor 6, z. Dorjan Vefi dhe 9, z. Donald Hoxhaj në deklaratën e kandidatit (Model 05);
18. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet për zonën zgjedhore **Qarku Lezhë** me numër rendor 6, z. Dorjan Vefi pika 7, 8 rezulton e pa plotësuar.
19. Deklarata e kandidatit (Model 05) për zonën zgjedhore **Qarku Fier** rezulton te ketë të pa përzgjedhur seksionin e deklarimit për kandidatin me numër rendor 5, z. Arben Myzeqari dhe rezulton të ketë të pa përcaktuar qarkun e kandidimit për kandidatin më numër rendor 17, zj. Almida Abazi;
20. Në zonën zgjedhore **Qarku Fier**, ka parregullsi në dokumentacioni e kandidimit të kandidatit me numër rendor 18, z. Gjergo Rafail;
21. Dokumentacioni i z. Kristi Gora nuk korrespondon me asnjë kandidat nga lista shumëmbrore e zonës zgjedhore **Qarku Fier**;
22. Në zonën zgjedhore **Qarku Fier**, rezulton e pa plotësuar pika 4, 5 seksion II dhe pika 8 në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 5, z. Arben Myzeqari;
23. Në zonën zgjedhore **Qarku Kukës**, në modelin 05 " Deklaratë e kandidatit" rezulton të jetë i pa përcaktuar qarku i kandidimit dhe subjekti zgjedhor nga kandidati më numër rendor 1, z. Edison Hasanaj;
24. Deklarata e kandidatit (Model 05) për zonën zgjedhore **Qarku Korçë** rezulton te ketë të pa përzgjedhur seksionin e deklarimit për kandidatin me numër rendor 10, z. Arjen Fatbardha dhe rezulton të ketë të pa përcaktuar qarkun e kandidimit për kandidatin më numër rendor 6, z. Kejdi Xhemollari;
25. Në zonën zgjedhore **Qarku Korçë**, rezulton e pa plotësuar pika 5 në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 11, z. Fernando Xhelollari;
26. Deklarata e kandidatit (Model 05) për zonën zgjedhore **Qarku Shkodër** rezulton të ketë të pa përzgjedhur seksionin e deklarimit për kandidatët me numër rendor 10, z. Redi Hebovija dhe 12, z. Renato Coku;



27. Në zonën zgjedhore **Qarku Shkodër**, rezulton e pa plotësuar pika 1, 3, 4, 5, 8 në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 4, z. Bahri Shabani;
28. Në zonën zgjedhore **Qarku Shkodër**, rezulton e pa plotësuar pika 8 në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 8. z. Gledis Lloshi;
29. Në zonën zgjedhore **Qarku Vlorë**, në modelin 05 ” Deklaratë e kandidatit” rezulton të jetë i pa përcaktuar qarku i kandidimit për kandidatin me numër rendor 9, zj. Stelina Tragaj dhe rezulton të jete i pa përcaktuar subjekti zgjedhor për kandidatin me numër rendor 5, z. Marildo Hodaj;
30. Deklarata e kandidatit (Model 05) për zonën zgjedhore **Qarku Vlorë** rezulton të ketë të përcaktuar qarkun e kandidimit për kandidatin me numër rendor 9 zj. Stelina Tragaj dhe rezulton të ketë të pa përcaktuar subjekti zgjedhor për kandidatin me numër rendor 5, z. Marildo Hodaj;
31. Në zonën zgjedhore **Qarku Elbasan**, rezulton e pa plotësuar pika 4 në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 1, z. Erion Murataj;
32. Në zonën zgjedhore **Qarku Elbasan**, rezulton e pa plotësuar pika 8 por janë dhënë specifikime të të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet me numër rendor 8, z. Erjon Gega;
33. Në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet në zonën zgjedhore **Qarku Elbasan** me numër rendor 11, z. Ilirjan Ruda rezulton që pika 8 të jetë e plotësuar me “JO” por janë dhënë specifikime të të dhënave;

Në bazë të nenit 73 pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dokumentacioni i depozituar kthehet për korrigjimin e mangësive të konstatuar nga Partia “Bindja Demokratike”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 67, 72 dhe 73, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe Udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”,



V E N D O S :

1. Kthimin për korrigjim, sipas gjetjeve të renditura më sipër, të dokumentacionit për regjistrimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për deputet, të Partisë “Bindja Demokratike”, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.
2. Dokumentacioni i korrigjuar të depozitohet brenda datës 16.03.2021.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

